

# Komunikojmë

Buletin tremujor mbi projektet për sistemin e drejtësisë në Shqipëri

JANAR – MARS 2014

NUMRI 13

## NË KËTË NUMËR:

### VEPRIMTARITË NË JANAR – MARS 2014

Praktikë Profesionale pranë Avokaturës së Shtetit për studentët e drejtësisë në UT	1
Rrjeti SEELS dhe zbatimi i legjislacionit të BE-së	1
“Për një drejtësi pa vonesa”	2
Nis projekti i përbashkët KE-BE	2
Një tjetër arritje në shtrirjen e regjistrimit dixhital audio në gjykatat shqiptare	2
Projekti i IPA 2010 drejt përfundimit	2
Shoqëria civile ndërgjegjëson publikun për regjistrimin audio të seanceve gjyqësore	2
Vazhdon mbështetja për Prokurorinë e Krimeve të Rënda	3
Konferenca e parë ndërkombëtare “Parandalimi i Krimit ndaj Mjedisit në Shqipëri”	3
Trajnimi i tretë mbi ndihmën e ndërsjellë juridike dhe ekstradimet	3
Rritja e ndërgjegjësimin të komuniteteve të së drejtës dhe biznesit mbi ADR-në	3
Revista Juridike e Evropës Juglindore	4
Përfundon viti II i kurseve të AVL-së	4
Vijon fushata kundër korrupsionit	4

### VEPRIMTARITË E PARASHIKUARA NË PRILL – QERSHOR 2014

## NUMRAT E MËPARSHËM

Për t'i lexuar, klikoni ikonat e mëposhtme.



## Të nderuar lexues,

Në këto dy vitet e fundit, Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës (FDUT) ka ndryshuar ndjeshëm imazhin e tij. Janë shtuar dhe përmirësuar ndjeshëm standardet e planeve dhe programeve mësimore të edukimit juridik si edhe ato të infrastrukturës fizike. Në vendet e BE-së dhe në SHBA, partneriteti i fakulteteve të ligjit me aktorë të rëndësishëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë është një traditë e cila jep fryte të mira në fushën e studimeve juridike dhe në përmirësimin e legjislacionit. Përfshirja e Fakultetit në fokusin e interesave të këtyre partnerëve është garanci për zhvillimin e sektorit të formimit juridik si fidanishja e sistemit të drejtësisë në vend.

Iniciativat e bashkëpunimit efektiv me partnerë të ndryshëm përbëjnë risinë kryesore gjatë kësaj periudhe. Në këtë kuadër vlen të përmendet partneriteti me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara, atë të Francës, Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, GIZ-in, Fondacionin “Konrad Adenauer”, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, Dhomën Amerikane të Tregtisë në Shqipëri dhe Dhomën Kombëtare të Noterisë, me synim forcimin e cilësisë së arsimimit juridik në Shqipëri. Një ndër projektet më ambicioze dhe të suksesshme është ai për instalimin e standardeve të edukimit klinik ligjor në Fakultetin e Drejtësisë, një dimension i munguar deri më tani. I konceptuar dhe finalizuar me mbështetjen e USAID-it, ky projekt e vë theksin në angazhimin drejt prires së aftësisë praktikë-profesionale të studentëve të drejtësisë. Klinika e ligjit, e cila tashmë funksionon në Fakultet, ka filluar të japë frytet e para. Për më tepër, vlen të përmendet dhe krijimi i programit ndërdisiplinor Master “Administrimi i Institucioneve Sociale në Sistemin e Drejtësisë”, i ideuar dhe mbështetur nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

Përpjekjet tona synojnë të formulojnë një vizion që të mbështesë prioritetet e veprimit tonë universitar për forcimin e arsimimit juridik, si një hap më shumë drejt realizimit të qëllimit të përbashkët, të thellimit cilësor dhe përmirësimit të mtejshëm të standardeve të gjithanshme, mbështetur në energjinë pozitive të të gjithë aktorëve të veprimit universitar.

Thellimi i bashkëpunimit me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare do të bëjë të mundur që FDUT-ja të vazhdojë të jetë institucioni lider i arsimit të lartë juridik në Shqipëri. Motoja jonë ka qenë dhe do të mbetet: “Të jemi institucion lider dhe të ofrojmë më të mirën për një formim juridik bashkëkohor”.

## Sinqerisht,

Prof. Dr. Altin Shegani

Dekan i FDUT-së

## VEPRIMTARITË NË JANAR – MARS 2014

### Praktikë Profesionale pranë Avokaturës së Shtetit për studentët e drejtësisë në UT

Avokatura e Shtetit, në bashkëpunim me Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës (FDUT) dhe me mbështetjen e USAID-it dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, shpalli në mars Programin e parë të Praktikës Profesionale pranë këtij institucioni për studentët e vitit të fundit në Programet Master Profesional dhe Master Shkencor në FDUT. Pas procesit të aplikimit dhe përzgjedhjes, 21 studentët pjesëmarrës e kanë nisur tashmë këtë përvojë formuese gjashtëmujore, që u ofron atyre mundësi për punë praktike ligjore, për të mbushur kështu boshllëkun që ekziston mes teorisë dhe praktikës në arsimimin ligjor shqiptar dhe për t'i aftësuar ata sa më të mirë në aspektin profesional si juristë të ardhshëm.

### Rrjeti SEELS dhe zbatimi i legjislacionit të BE-së

Një nga projektet në kuadër të Rrjetit të Fakulteteve të Drejtësisë në Evropën Juglindore (SEELS) që mbështetet nga GIZ ORF-LR, është “Aplikimi i legjislacionit të Bashkimit Evropian nga gjykatat kombëtare të vendeve të EJK-së”. Ky projekt ofron një model teorik për të udhëzuar kapacitetin e gjykatave të rajonit në aplikimin e legjislacionit të BE-së në periudhën e para-aderimit (i aplikueshëm në një masë të madhe dhe për periudhën pas pranimit në BE). Sipas këtij modeli, projekti do të zhvillojë një komizë teorike dhe praktike për monitorimin e kapaciteteve të gjykatave të vendeve të EJK-së lidhur me zbatimin e legjislacionit të BE-së gjatë fazave të para-aderimit. Kjo praktikë do të kontribuojë në monitorimin e regullt periodik të kapacitetit dhe praktikave të

gjykatave kombëtare nga institucionet përkatëse të shteteve të veçanta si dhe të rajonit. Projekti ka nisur tashmë një studim fillestar të praktikave ekzistuese të gjykatave të EJK-së në bazë vendi dhe krahasuese rajonale. Gjetjet fillestare të ekspertëve nga Fakultetet e Drejtësisë, anëtare të SEELS-it, u prezantuan dhe u diskutuan në Konferencën Rajonale të organizuar nga Fakulteti i Drejtësisë në Beograd, më 25 dhe 26 mars 2014. Rezultatet e studimit do të publikohen në një botim të veçantë të SEELS-it.



Nga Konferenca Rajonale e SEELS-it, Beograd, Serbi, 25 - 26 mars 2014.

## “Për një drejtësi pa vonesa”

Falë bashkëpunimit mes projektit JuST të USAID-it dhe Prezencës së OSBE-së në Shqipëri dhe me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në shkurt 2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë filloi zbatimin e praktikave për një menaxhim aktiv të çështjeve gjyqësore, për të shmangur kështu seancat pa rezultate, kohën e humbur dhe vonesat e panevojshme. Projekti pilot i titulluar “Për një drejtësi pa vonesa” iu prezantua aktorëve vendorë më 27 janar 2014. Ai përfshin disa objektiva specifike, si p.sh. ulja e numrit të seancave nga mesatarja aktuale 14 në 4 për çështjet komplekse civile dhe nga 9 në 3 të tilla për çështjet penale. Praktikave të zbatuara tashmë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë përfshijnë përmirësimin e praktikës së paraqitjes së provave, të zhvillimit të seancave paraprake dhe kontaktit me palët. Bazuar në rezultatet pozitive, tashmë po planifikohet shtrirja e këtij projekti edhe në një gjykatë të dytë, atë të rrethit gjyqësor Korçë.

## Një tjetër arritje në shtrirjen e regjistrimit dixhital audio në gjykatat shqiptare

Me mbështetjen e USAID-it, brenda marsit 2014 mbëriti në 25 numri i gjykatave të pajisura në çdo sallë gjyqi me teknologjinë e regjistrimit dixhital audio (RDA), ku përfshihen të gjitha gjykatat në 5 rajonet e apelit: Korçë, Durrës, Tiranë, Vlorë dhe Gjirokastrë, si dhe gjykatat për krime të rënda. Përdorimi i RDA-së në gjykata ndiqet rregullisht sipas datës, çështjes gjyqësore, vendndodhjes dhe emrit të gjyqtarit, falë aplikacionit PAKS+ të krijuar me ndihmën e projektit JuST të USAID-it, që është instaluar në të gjitha këto gjykata. Raportet automatike i paraqiten periodikisht Ministrisë së Drejtësisë në përputhje me kërkesën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë për RDA-në. Për të diskutuar mbi përvojën në përdorimin e RDA-së në rajonin e apelit Vlorë, projekti JuST organizoi në 27 shkurt, Konferencën e katërt Rajonale të Liderimit në Gjyqësor, me mbi 100 pjesëmarrës nga gjykatat e rretheve Vlorë, Fier, Berat e Lushnjë dhe Gjykata e Apelit Vlorë.

## Shoqëria civile ndërgjegjëson publikun për regjistrimin audio të seancave gjyqësore

Nën sloganin: “Regjistrimi Dixhital Audio: Në sallat e gjyqit, gjithçka që thuhet, tani regjistrohet”, Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (A.L.T.R.I) ka ndërmarrë në 14 rrethe të vendit një fushatë gjashtëmujore

## Nis projekti i përbashkët KE-BE

“Rritja e efikasitetit të Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri, në përputhje me standardet evropiane” është një projekt i ri 24-mujor nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian, që ka filluar zyrtarisht në janar 2014. Projekti, i financuar kryesisht nga BE-ja, fokusohet në mbështetjen dhe ndihmën për autoritetet gjyqësore në zhvillimin e një sistemi gjyqësor efikas, në përputhje me strategjinë e reformës në drejtësi dhe standardet evropiane. Kjo do të realizohet nëpërmjet vënies në zbatim të instrumenteve dhe metodologjisë të hartuara nga Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), si dhe forcimit të kapaciteteve të aktorëve kryesorë në gjyqësor dhe të personelit të gjykatave. Projekti synon rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të gjykatave dhe proceseve gjyqësore dhe përmirësimin e statusit, të organizimit dhe profesionalizmit të stafit të gjykatave, si dhe të cilësisë së shërbimeve publike nga drejtësia dhe gjykatat. Aktivitetet e projektit përfshijnë ndër të tjera: - Vlerësim të thelluar

të sistemit gjyqësor në Shqipëri; - Shtrirje në të gjitha gjykatat të Programit të CEPEJ të Trajnimit për Gjykatat mbi Udhëzimet e SATURN-it për menaxhimin e kohës gjyqësore; - Përmirësim të mbledhjes dhe analizës së statistikave gjyqësore në funksion të hartimit të politikave; - Forcimi të kapaciteteve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Inspektoratit Gjyqësor; - Analizë të organizimit të gjykatave dhe të kapacitetit të administratorëve të tyre; - Shqyrtim të moduleve të trajnimit për gjyqtarët dhe personelin e gjykatave; - Rritje të kapaciteteve të Shkollës së Magistraturës; - Vizita studimore të personelit të Gjykatës Kushtetuese në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut; - Anketa në 10 gjykata mbi sa të kënaqur janë qytetarët nga shërbimet që jepen dhe zhvillimi i planeve në të bazë të rezultateve; - Përmirësim të qasjes së publikut në vendimet e gjykatave; - Përmirësim të marrëdhënieve midis gjykatave dhe medias.

*“Rritja e efikasitetit të Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri, në përputhje me standardet evropiane” Këshilli i Evropës, Zyra Tiranë • Sheshi Skënderbej • Pallati i Kulturës, Kati i parë • Tel: +355 4 222 84 19 / 4 225 42 87 • www.coe.al*

## Projekti i IPA 2010 drejt përfundimit

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2014, projekti “Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit: Forcimi i Rrjetit të Prokurorëve”, i financuar nga IPA 2010 e BE-së dhe i zbatuar nga GIZ dhe CILC, u përqendrua në finalizimin e një sërë aktivitetesh. Kështu, projekti përgatiti dhe botoi një Manual për Ekipe të Përbashkëta të Hetimit të zbatueshëm në vendet e Ballkanit Perëndimor, si dhe realizoi vlerësimin e legjislacionit përkatës për ndihmën e ndërsjellë juridike në vendet e rajonit. Në bashkëpunim me Shkollën e Magistraturës, projekti organizoi një tjetër trajnim kombëtar për ndihmën juridike ndërkufitare, bazuar në programet e trajnimeve të mëparshme. Në seminarin e drejtuar nga 3 ekspertë vendas morën pjesë rreth 20 prokurorë. Përveç këtyre, projekti

ofroi kurse të anglishtes ligjore për më shumë se 30 prokurorë nga Prokuroria e Përgjithshme (PP) dhe Prokuroria e Rrethit të Tiranës. Ndërkohë, 14 prokurorë dhe oficerë policie të specializuar të luftës kundër krimit të organizuar në të gjitha vendet përfituese morën pjesë në një vizitë studimore në institucionet ligjzbatuese që luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar në Austri dhe në Republikën Çeke. Po kështu, një tjetër vizitë studimore në Rumani u përqendrua të çështjet e krimit të organizuar dhe korrupsionit në nivelet e larta. Projekti organizoi dhe një takim për 25 prokurorë të rajoneve kufitare të Shqipërisë dhe Maqedonisë, me synim rritjen e bashkëpunimit të ndërsjellë duke diskutuar së bashku mbi përvojat dhe sfidat, bazuar në praktikën e përditshme. Ideja u mbështet fuqimisht nga drejtoritë përkatëse të marrëdhënieve juridike me jashtë në PP-të e këtyre dy vendeve. Projekti përfundon në prill 2014.

ndërgjegjësimi e avokimi për RDA-në në gjykatat shqiptare, me mbështetjen e një granti nga projekti JuST i USAID-it. Mes të tjerave, fushata përfshin transmetimin e një reklame televizive dhe për radio mbi RDA-në në media lokale dhe kombëtare dhe një sërë aktivitetesh publike, si p.sh., ditët e hapura në gjykatë, ku përfshihet edhe organizimi i një gjyqi imitues nga studentë të drejtësisë. Qytetarëve po u shpërndahen CD me etiketën “Merr kopjen tënde”, të shoqëruar me materiale informuese mbi RDA-në, ndërsa në internet, në rrjetet sociale kanë nisur postimet nën frazën: #RegjistrimiAudioNeGjykata. Fushata përfshin edhe monitorimin e përdorimit të teknologjisë së re RDA në 15 gjykata, si dhe

avokimin ndaj vendimmarrësve për standarde të njëjta në funksionimin e saj.



*Ndërgjegjësim mbi RDA-në, Qendra A.L.T.R.I në kuadër të një granti nga USAID JuST, mars 2014.*

## Vazhdon mbështetja për Prokurorinë e Krimeve të Rënda

OPDAT-Shqipëri vijoi asistencën për Prokurorinë e Krimeve të Rënda (PKR) me organizimin e disa programeve të trajnimit dhe këshillimit. Më 12 shkurt, Këshilltari Rezident Ligjor Vaccaro organizoi një seminar mbi “Marrëveshjet e bashkëpunimit dhe përdorimin e bashkëpunësorëve të drejtësisë”, ku morën pjesë prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore (OPGJ), për të diskutuar mbi nevojën për të punuar me këta bashkëpunësorë si një mjet thelbësor për të pasur sukses në çështjet kundër krimit të organizuar. Përmes prezantimeve mbi sistemin dhe rasteve studimore në SHBA, Z. Vaccaro vuri në dukje avantazhet e përdorimit të bashkëpunësorëve, si dhe teknikat e trajtimit të tyre para dhe gjatë gjyqit. Në

26 - 27 mars, në bashkëpunim me Zyrën e Atasheut Ligjor të FBI-së në Sofje, OPDAT-i vijoi me organizimin e një Seminari mbi Krimin Kibernetik për prokurorët dhe OPGJ-të e PKR-së. Temat përfshinë prezantimin mbi hetimin kibernetik, kërkimin në burimet e hapura të informacionit në internet, rrjetet sociale dhe “hacktivizm”-in, si dhe një rast studimor. Gjatë seminarit u vu re nevoja e anëtarëve të PKR-së për më shumë ekspozim ndaj informacionit në këto fusha dhe kapaciteteve aktuale teknologjike. Më 11 - 13 mars, OPDAT-Shqipëri sponsorizoi një Seminar Kombëtar për Trafikimin e Qenieve Njerëzore për rreth 25 pjesëmarrës nga PKR-ja (prokurorë dhe OPGJ), hetues të Policisë së Shtetit, si dhe specialistë të anti-trafikimit në Zyrën e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore. Dy ekspertet nga SHBA-ja, Znj. Jessica Ginsburg nga Departamenti i Drejtësisë dhe Znj. Katerina Kane nga ai i Sigurisë Kombëtare,

përkrauan me hollësi për pjesëmarrësit parimet ligjore lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore dhe shembuj e tendencat aktuale në SHBA, teknika të hetimit dhe sfidat në rastet e trafikimit, çështje të lidhura me viktimat, si dhe strategjitë dhe bashkëpunimin ndërkombëtar për zbatimin e ligjit duke përfshirë traktatet e ndihmës së përbashkët juridike dhe të ekstradimit mes dy vendeve. Në mars, OPDAT koordinoi dhe vizitën nga SHBA-ja të një prokurori nga Divizioni i Sigurisë Kombëtare në Departamentin e Drejtësisë për t'i ofruar PKR-së këshillim dhe ndihmës në ndërtimin e çështjeve të suksesshme kundër terrorizmit, si dhe për të shqyrtuar ndryshimet e propozuara në Kodin Penal për penalizimin e marrjes së trajnimit për terrorizëm apo të udhëtitimit jashtë vendit për të marrë pjesë në veprimtari terroriste. Si rezultat, OPDAT-i i paraqiti Komisionit Parlamentar të Ligjeve komente të specializuara për këto ndryshime.

## Konferenca e parë ndërkombëtare “Parandalimi i Krimit ndaj Mjedisit në Shqipëri”



Krimet ndaj mjedisit për shkak të kompleksitetit të tyre dhe natyrës multidimensionale janë shpesh të vështira të zbulohen, hetohen dhe të ndiqen si duhet penalisht, duke e transformuar luftën kundër tyre në një sfidë të madhe për çdo institucion ligjzbatues. Situata rreth krimit ndaj mjedisit ishte tema e Konferencës së parë Ndërkombëtare për “Parandalimin e Krimit

ndaj Mjedisit në Shqipëri”, më 18 mars 2014. Kjo konferencë u organizua në kuadër të projekteve “Konsolidimi i Kapaciteteve Ligjzbatuese në Shqipëri” (PAMECA IV) dhe “Asistenca Teknike për Forcimin e Kapacitetit të Ministrisë së Mjedisit në Shqipëri për Hartimin dhe Zbatimin e Legjislacionit Kombëtar Mjedisor” (SELEA). Në të morën pjesë zyrtarë të lartë nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mjedisit dhe Prokuroria e Përgjithshme. Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e çështjeve që lidhen me mjedisin, Konferenca pati si qëllim mbledhjen së bashku të përfaqësuesve të agjencive ligjzbatuese, si gjyqtarë, prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore, inspektorë të mjedisit dhe ekspertë të njohur kombëtarë dhe ndërkombëtarë, për të diskutuar mbi nevojën e përmirësimit të Kodit Penal shqiptar për ta sjellë atë më afër standardeve të Direktivës së BE-së 2008/99 “Për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet të drejtës penale”. Kjo Konferencë shërbeu edhe si platformë për të paraqitur përvojat e BE-së në luftën kundër krimit mjedisor.

## Trajnimi i tretë mbi ndihmën e ndërsjellë juridike dhe ekstradimet

Në 31 mars - 1 prill, OPDAT-Shqipëri, në bashkëpunim me Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë të Departamentit të Drejtësisë të SHBA-së, organizoi Trajnimin e 3-të mbi ndihmën e ndërsjellë juridike dhe ekstradimet për specialistët shqiptarë nga Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Në të morën pjesë dhe prokurorë e oficerë të policisë gjyqësore nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, si dhe prokurorë nga disa prokurori të rretheve. Programi përfshiu prezantime mbi përdorimin e kanaleve jogjyqësore për marrjen e asistencës nga SHBA-ja, përfitimim e ndihmës së ndërsjellë juridike, kërkesat për marrjen e provave elektronike, sistemin për ekstradimin e personave në kërkim, përgatitjen e një kërkesë të suksesshme ekstradimi, si dhe udhëzime për shkrimin e kërkesave të efektshme të ekstradimit dhe ndihmës së ndërsjellë juridike. U trajtuan edhe skenarë hipotetikë lidhur me raste të ekstradimit dhe ndihmës së ndërsjellë juridike.

## Kritja e ndërgjegjësimit të komuniteteve të së drejtës dhe biznesit mbi ADR-në

Nisur nga rëndësia e dhënies së informacionit të nevojshëm për publikun e duhur dhe të interesuar, GIZ organizoi një sërë aktivitetesh informuese përmes Fondit të Hapur Rajonal për Evropën Juglindore - Reforma ligjore (ORF-LR), në kuadër të nënprojektit “Zbatimi i mjeteve alternative për zgjidhjen e konflikteve (ADR) i orientuar nga barazia gjinore në Ballkanin Perëndimor”. Veprimtaritë të cilat përfshinë trajnime me magjistratë në Shkollën e Magjistraturës, leksione

me studentë të drejtësisë, tryeza të rumbullakëta me avokatë dhe anëtarë të komunitetit të biznesit në Shqipëri, u zhvilluan gjatë javës së parë të shkurtit 2014. Në to dhanë kontribut kryesor ekspertët e ftuar ndërkombëtarë me përvojë, Dr. Judith Knieper, nga Sekretariati i UNCITRAL-it dhe Z. Ilija Mitrev Penusliski, nga studioja ligjore ndërkombëtare “Shearman & Sterling”. Ky i fundit prezantoi arbitrazhin ndërkombëtar në përgjithësi, avantazhet dhe ciklin e tij, si dhe Konventën e Nju Jorkut, mbi të cilën, së fundi, është krijuar një faqe interneti si një mundësi për vendet anëtare për të paraqitur rastet e tyre. Numri dhe pjesëmarrja aktive në veprimtaritë e organizuara dëshmuar interesin e lartë të juristëve

dhe përfaqësuesve të biznesit për procedurat e arbitrazhit. Duke marrë parasysh suksesin e tyre, GIZ planifikon të organizojë aktivitete të tilla në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.



Veprimtari informuese mbi ADR-në, GIZ ORF-LR, shkurt 2014.

## Revista Juridike e Evropës Juglindore

Në janar 2014, si pjesë e aktiviteteve të tij, Rrjeti i Fakulteteve të Drejtësisë në Evropën Juglindore (SEELS) botoi Revistën Juridike të Evropës Juglindore. Kjo është revista e parë e këtij lloji në gjuhën angleze në rajon. Ajo iu ofron atyre që studiojnë dhe praktikojnë ligjin një hapësirë për shkëmbime shkencore mbi çështjet e reformës legislative dhe harmonizimin e ligjeve në nivel kombëtar, të lidhura ngushtë me bashkëpunimin rajonal dhe integrimin evropian. Thirrja për artikuj për numrin e dytë të Revistës Juridike të Evropës Juglindore gjendet tashmë në faqen e internetit të SEELS-it: [www.seelawschool.org](http://www.seelawschool.org).

## Përfundon viti II i kurseve të AVL-së

Muaji shkurt 2014 shënoi përfundimin me sukses të vitit të dytë të Programit pilot të Arsimit Vazhdues Ligjor (AVL) për avokatët dhe asistent-avokatët, i organizuar nga projekti JuST i USAID-it në partneritet me Dhomën Kombëtare të Avokatisë (DHKA) dhe dhomat rajonale në Vlorë dhe Durrës. Gjatë këtij viti, programi u shtri dhe në një dhomë të tretë, atë të Fierit. Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në vitin e parë dhe të dytë kapërceu 550 vetë. Tani po diskutohet me DHKA-në dhe Shkollën Kombëtare të Avokatisë të sapokrijuar për zhvillimin e kurseve të ardhshme të AVL-së në Shqipëri.

## Vijon fushata kundër korrupsionit

OPDAT-i vazhdoi veprimtaritë e fushatës së ndërgjegjësimit publik kundër korrupsionit, në partneritet me Prokurorinë e Përgjithshme dhe Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun të Ambasadës së SHBA-së në Tiranë. Prokurorë të Njësitë të Përbashkëta të Hetimit vijuan prezantimet mbi çështjet e korrupsionit në shkollat e mesme publike. Në mars, në Muzeun Kombëtar u hap një ekspozitë me punimet e nxënësve të shkollave të mesme pjesëmarrës në konkursin për krijimin e posterave kundër korrupsionit. Si pjesë e fushatës u realizua dhe një reklamë televizive e cila u shfaq në 6 kanale të ndryshme. Atë mund ta shihni dhe në internet, në mediat sociale.

## VEPRIMTARITË E PARASHIKUARA NË PRILL – QERSHOR 2014

- Konferenca e Arbitrazhit, Gjyqi imitues dhe Tryeza të rumbullakëta mbi Kodin e Etikës, GIZ ORF-LR, Beograd, Serbi, 4 - 6 prill 2014
- Trajnime mbi etikën gjyqësore (4 seminare), OPDAT-Albania, 7 - 11 prill 2014
- Takim i Nivelit të Lartë mbi projektin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë “Për një drejtësi pa vonesa”, organizuar me mbështetjen e USAID JuST dhe Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ministria e Drejtësisë, 9 prill 2014
- Kolokiumi i studimeve të pas-doktoraturës në të drejtën publike nga SEELS, GIZ ORF-LR, Tiranë, 10 - 11 prill 2014
- Shpallja e fituesve të konkursit të nxënësve të shkollave të mesme për krijimin e posterave kundër korrupsionit, aktivitet mediatik në kuadrin e fushatës së ndërgjegjësimit publik kundër korrupsionit, OPDAT-Shqipëri, 17 prill 2014
- Tryeza e rumbullakët tremujore me Njësitë e Përbashkëta të Hetimit, OPDAT-Shqipëri, 30 prill 2014
- Botimi i numrit të 10-të të revistës juridike “Avokatia”, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, me mbështetjen e USAID JuST, prill 2014
- Aktivitet në “Pedonale” në Ditën e Drejtësisë, në kuadrin e fushatës së ndërgjegjësimit mbi regjistrimin dixhital audio në gjykatat shqiptare, Qendra A.L.T.R.I, me mbështetjen e USAID JuST, Tiranë, 10 maj 2014
- Vizitë nga Shkolla e Magjistraturës në Institutin Kombëtar të Drejtësisë në Bullgari, OPDAT-Shqipëri, 12 - 16 maj 2014
- Vizitë studimore nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, OPDAT-Shqipëri, Siçili, Itali, 19 - 23 maj 2014
- Konferenca Rajonale e SEELS “Promovimi i kërkimit shkencor dhe arsimit për integrimin evropian dhe politikat”, GIZ ORF-LR, Rijeka, Kroaci, 27 - 28 maj 2014
- Botimi i manualit rreth procedurës civile për avokatët e rinj që do të shpërndahet dhe promovohet në fakultetet e drejtësisë dhe në dhomat e avokatisë si dhe do të shoqërohet me seanca trajnime profesionale, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, maj 2014
- Përfundimi i punës për ngritjen e një hapësire të re për shërbimin dhe informimin e publikut në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, USAID JuST, maj 2014
- Fillimi i projektit të ri EURALIUS, maj 2014
- Konferenca e 11-të rajonale “E drejta private ndërkombëtare në jurisprudencën e gjykatave evropiane - Familja në fokus”, GIZ ORF-LR, Osijek, Kroaci, 11 - 12 qershor 2014
- Konferenca Rajonale në Ballkan kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, OPDAT-Shqipëri, 17 - 19 qershor 2014
- Konferenca Rajonale e SEELS “E drejta administrative e BE-së dhe ndikimi i saj në procesin e reformës së administratës publike dhe integrimi në hapësirën evropiane administrative të vendeve të EJT-së”, GIZ ORF-LR, Zagreb, Kroaci, 17 - 20 qershor 2014



USAID JuST  
E-mail: [office@ajssp.org.al](mailto:office@ajssp.org.al)  
[www.osce.org/albania](http://www.osce.org/albania)



Prezenca e OSBE-së në Shqipëri  
E-mail: [pm-al@osce.org](mailto:pm-al@osce.org)  
[www.osce.org/albania](http://www.osce.org/albania)



OPDAT-Shqipëri  
E-mail: [VaccaroMR@state.gov](mailto:VaccaroMR@state.gov)  
[www.justice.gov/criminal/opdat](http://www.justice.gov/criminal/opdat)



GIZ ORF-LR  
E-mail: [christian.athenstaedt@giz.de](mailto:christian.athenstaedt@giz.de)  
[www.giz.de](http://www.giz.de)



E-mail: [orflex-al@giz.de](mailto:orflex-al@giz.de)  
[www.giz.de](http://www.giz.de)



E-mail: [info@pameca.org.al](mailto:info@pameca.org.al)  
[www.pameca.org.al](http://www.pameca.org.al)



E-mail: [Tea.Jalishvili@coe.int](mailto:Tea.Jalishvili@coe.int)  
[www.coe.al](http://www.coe.al)

## Shprehjet e falënderimit dhe mbi përgjegjësitë

Artikujt e këtij buletini janë kontribute të projekteve të donatorëve të cilët mbështesin aktivisht reformën në sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Kontribuuesit mbajnë përgjegjësi të plotë për përbajtjen e artikujve të tyre, të cilat nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorëve apo qeverive përkatëse.